



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:243518

Datë: 18.06.2024

Numri i dokumentit: 05829240

P.nr.3152/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Bujar Ahmeti dhe praktikantin gjyqësor Sulltan Qallapeku, në çështjen penale kundër të pandehurve V.M. dhe B.K., për shkak të veprës penale vjedhje në bashkëkryerje, nga neni 313 par.1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.5027/21 të datës 29.10.2021, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit fillestar publik me datë 11.06.2024, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Valdrin Krasniqi dhe të pandehurit B.K., në të njëjtën ditë publikisht mori dhe shpalli, ndërsa me datë 18.06.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. I pandehuri,

B.K., nga babai N. dhe nëna F., mbiemri i vajzërisë se nënës S., i lindur me datë ..., i pa martuar, punon, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën fillore, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar me numër personal ...

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 06.10.2021 në intervalin kohor 11:00-12:30h, në Prishtinë, në rrugën “Ndue Perllushi” në Prishtinë, tek Kompleksi 2Sarajet e Matit”, të pandehurit V.M. dhe B.K. pas një marrëveshje paraprake në bashkëkryerje, me dashje, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër, kanë shkuar në ndërtesën e lartcekur dhe aty kanë marrë të mbathura si patika – mbathje sportive dhe atë para derës së banesës së të dëmtuarit V.L., ku i kanë marrë një palë patika “Adidas”, ngjyrë e zezë në vlerë prej 100 € dhe një palë patika të prindit të tij të dëmtuarit Xh.L., me ngjyrë të gjelbër me të verdhë në vlerë prej 50 €, si dhe para derës së banesës së të dëmtuarit F.B., kanë marrë një palë patika “Rebook” ngjyrë e zezë në vlerë prej 20 €, të cilat i kanë gjetur para dymave të banesave duke i futë në çanta dhe dalin nga ndërtesa ashtu siç shihen në videoincizmet e kamerave të sigurisë, e të cilat identifikohen nga policia përmes këtyre videoincizimeve dhe prej aty shkojnë në tregun tek Plepat – Komuna e vjetër, ku i shesin për shumën prej 30 €.

- Me këto veprime i pandehuri B.K. ka kryer veprën penale *vjedhje në bashkëkryerje, nga neni 313 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.*

Prandaj, kjo gjykatë në bazë të neneve 4, 7, 8, 17, 21, 38, 39 par.1 pika 1.1 dhe 1.2, 40 par.1 pika 1.3, 43, 46, 47, 48, 69, 70, nenit 313 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, nenit 242, 364 dhe 449 të KPP-së, të pandehurin B.K. e:

G J Y K O N

Me **DËNIM ME BURGIM** në kohëzgjatje prej nëntëdhjetë (90) ditë, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin prej një (1) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i pandehuri brenda kësaj periudhe nuk kryen vepër të re penale; dhe

Me **DËNIM ME GJOBË** në shumë prej 300 € (treqind euro), të cilin dënim obligohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën në afatin e caktuar, gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 par. 3 të KPRK-së, ashtu që dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burgim, ku një ditë burgim do të llogaritet me 20 € (njëzet euro) të gjobës.

Të dëmtuarit V.L., Xh.L., dhe F.B., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.

I pandehuri B.K., obligohet që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë: në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20 € (njëzet euro) dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 20 € (njëzet euro), të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. Në kuptim të nenit 362 par. 1 pika 1.3 të KPP-së për të pandehurin:

V.M. nga i ati Xh., dhe nëna E., e gjinisë S., i lindur me datë ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal ...

REFUZOHET AKUZA

Për shkak të vdekjes së të pandehurit

Sepse:

Me datë 06.10.2021 në intervalin kohor 11:00-12:30h, në Prishtinë, në rrugën “Ndue Perllëshi” në Prishtinë, tek Kompleksi 2Sarajet e Matit”, të pandehurit V.M. dhe B.K. pas një marrëveshje paraprake në bashkëkryerje, me dashje, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër, kanë shkuar në ndërtesën e lartcekur dhe aty kanë marrë të mbathura si patika – mbathje sportive dhe atë para derës së banesës së të dëmtuarit Valon Leci ku i kanë marrë një palë patika “Adidas”, ngjyrë e zezë në vlerë prej 100 € dhe një palë patika të prindit të tij të dëmtuarit Xhavit Leci me ngjyrë të gjelbër me të verdhë në vlerë prej 50 €, si dhe para derës së banesës së të dëmtuarit Fisnik Batusha kanë marrë një palë patika “Rebook” ngjyrë e zezë në vlerë prej 20 €, të cilat i kanë gjetur para dyerve të banesave duke i futë në çanta dhe dalin nga ndërtesa ashtu siç shihen në videoincizmet e kamerave të sigurisë, e të cilat identifikohen nga policia përmes këtyre

videoincizimeve dhe prej aty shkojnë në tregun tek Plepat – Komuna e vjetër, ku i shesin për shumën prej 30 €.

- Me këto veprime i pandehuri V.M. kishte për të kryer veprën penale *vjedhje në bashkëkryerje, nga neni 313 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.*

Të dëmtuarit V.L., Xh.L., dhe F.B., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.

Shpenzimet e procedurës penale për pjesën refuzuese, bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Rrjedha e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën e saj me numër PP.II.nr.5027/21 të datës 29.10.2021 të pandehurit V.M. dhe B.K. i ka akuzuar për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale vjedhje, nga neni 313 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata pas vlerësimit të kompetencës lëndore dhe territoriale dhe duke vepruar sipas aktakuzës, me datë 11.06.2024 ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilin seancë prezent ishin Prokurori i Shtetit Valdrin Krasniqi dhe i pandehuri B.K..

Para fillimit të seancës së shqyrtimit fillestar, gjykata ka marrë njoftimin se i pandehuri V.M. ka vdekur në shkurt të vitit 2024. Gjykata ka bërë verifikimin përmes sistemit të Gjendjes Civile, me ç'rast nga Agjencia i Regjistrimit Civil gjykata ka pranuar certifikatën e vdekjes për të pandehurin V.M. ku vërtetohet se i njëjti ka vdekur me datë 26.02.2024, certifikatë kjo e cila i është bashkangjitur shkresave të lëndës.

Gjyqtari i vetëm gjykuese në seancën e shqyrtimit fillestar e ka vazhduar me të pandehurin B.K., me ç'rast të njëjtin e ka udhëzuar për të drejtat konform nenit 241 par. 1 të KPP-së. Pas kësaj, Prokurori i Shtetit e ka lexuar aktakuzën dhe pasi gjyqtari u bind se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, bazuar në dispozitën e nenit 241 par. 4 të KPP-së të njëjtit i ofroi mundësinë që të pranojë fajësinë ose të deklarohej i pafajshëm.

Në seancën e shqyrtimit fillestar i pandehuri B.K. pas sqarimeve të nevojshme nga ana e gjykatës, deklaroi se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza, se është i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe palës së dëmtuar dhe premtori se në të ardhmen nuk do të përsëris veprime të tilla apo të ngjashme, njëherit i propozon gjykatës që t'i shqiptoj një dënim më të butë.

Pasi që i pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar e ka pranuar fajësinë, konform nenin 242 par.5 të KPP-së gjyqtari ka marrë mendimin e Prokurorit të Shtetit prezentë lidhur me deklarinimin e pranimit të fajësisë të bërë nga i pandehuri, me ç'rast i njëjti ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pasi që është në pajtim të plotë me dispozitën e nenit 242 të KPP-së dhe po ashtu është në harmoni të plotë edhe me provat që gjenden në shkresat e lëndës, me të cilat vërtetohet

se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, andaj i ka propozuar gjykatës që ta miratoj pranimin e fajësisë. Ndërkaq, sa i përket rrethanave lidhur me matjen dhe caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, prokurori ka propozuar që si rrethanë lehtësuese gjykata të merr parasysh pranimin e singertë të fajësisë.

Vlerësimi i gjykatës lidhur me pranimin e fajësisë.

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i pandehuri B.K. dhe erdhi në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në pajtim me nenin 242 par. 2 të KPP-së dhe në pajtim me faktet dhe provat që përmban aktakuza, njëherit vlerësoi se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht dhe mbështetet në faktet dhe provat materiale të rastit konkret të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore apo gabime faktike, dhe po ashtu gjykata sipas detyrës zyrtare dhe konform nenit 251 të KPP-së, nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e papranueshme. Pasi gjyqtari i vetëm gjyquese u bind se i pandehuri e ka kuptuar natyrën, benefitet dhe pasojat e pranimin të fajësisë, si dhe pasi që konstatoi se pranimi është në përputhje me nenin 242 par. 2 të KPP-së, me aktvendim e aprovoi pranimin e fajësisë së të pandehurit, për veprën penale vjedhje në bashkëkryerje, nga neni 313 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Me qenë se i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjykata nuk është lëshuar në procedimin e provave në këtë çështje penale, por shqyrtimi fillestar ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjendja faktike e vërtetuar.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë se të pandehurit B.K. dhe nga provat të cilat i janë bashkangjitur shkresave të lëndës, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se në veprimet e të pandehurit formohen të gjitha elementet e veprës penale vjedhje në bashkëkryerje, nga neni 313 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të përshkruar sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e për të cilën vepër penale është paraparë dënimi me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet, dhe për këtë gjykata ka vendosur që të pandehurin ta shpall fajtor dhe t'i shqiptoj dënimin më afër të përshkruar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tij penale juridike.

Rrethanat me rastin e matjes dhe lartësisë së dënimit.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Si rrethanë lehtësuese vlerësoi faktin e pranimin të fajësisë nga i pandehuri për veprën penale për të cilën akuzohet, bashkëpunimi i tij me gjykatën, keqardhjen e shfaqur nga i pandehuri për rastin e ndodhur, kërkim faljen dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej veprime të tilla apo të ngjashme, ndërsa si rrethana rënduese gjykata mori për bazë shkallën përgjegjësisë penale të pandehurit dhe shkallën e lartë të dashjes në kryerjen e veprës penale.

Pasi që për këtë vepër penale parashihet dënim kumulativ me gjobë dhe me burgim, gjykata pas vlerësimit të rrethanave lehtësuese dhe rënduese të elaboruara si më lartë, të pandehurit B.K. i shqiptoj

dënimin me burgim e të kushtëzuar dhe dënimin me gjobë sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimit. Gjykata përkitazi me dënimin me kusht mori për bazë keqardhjen e shfaqur për rastin që ka ndodhur, pendimin e shprehur, kërkim faljen dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të përsëris veprime të tilla, ndërsa me rastin e shqiptimit të dënimit me gjobë, gjykata mori për bazë gjenden e tij ekonomike dhe qëllimin që të mos rrezikohet mirëqenia e tij dhe anëtarëve të tjerë të familjes së tij. Gjykata në prani të këtyre rrethanave konsideron se i pandehuri e ka kuptuar rëndësinë e veprimeve të dëmshme, dhe në këtë mënyrë iu dha edhe një mundësi të pandehurit të kushtëzohet në ekzekutim të dënimit me burgim, duke i lënë një periudhë të verifikimit prej një viti pasi që gjykata paraprakisht u bind se i njëjti nuk do të përsëris veprimet e tilla, dhe mbi bazën e këtyre rrethanave, gjyqtari njëherit është i bindur se dënimi i shqiptuar me kusht dhe me gjobë është në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të të pandehurit, kështu gjykata vlerëson se me shqiptimin e dënimit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e veprës penale dhe të kryesit, po ashtu ky dënim do të shërbej në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale), si dhe do të arrihet qëllimi që t'i përmbaj edhe personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Lidhur me kërkesën pasurore juridike gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 462 par. 1 dhe 2 të KPP-së, ku të dëmtuarit V.L., Xh.L., dhe F.B., për realizmin e kërkesës pasurore juridike i udhëzoi në kontestin e rregullt juridiko civil.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Gjykata duke vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës penale, në kuptim të nenit 449 par. 2 nën par. 2.6 të KPP-së, obligoi të pandehurin B.K. që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € (njëzet euro). Po ashtu, konform nenit 36 par. 3 nën par. 3.1 të Ligjit Nr.08/L -109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjykata e obligoi të pandehurin të paguaj shumën prej 20 € (njëzet euro) në emër të Programit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

II. Gjykata ka vendosur sikurse në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimit, respektivisht për të pandehurin V.M. e ka refuzuar akuzën për veprën penale vjedhje në bashkëkryerje, nga neni 313 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, për shkak të vdekjes së të njëjtit.

Pas marrjes së njoftimit se i pandehuri ka vdekur, gjykata përmes kërkesës së datës 16.05.2024, drejtuar Zyrës së Gjendjes Civile në Prishtinë, ka kërkuar që të verifikoj faktin se i pandehuri a është i regjistruar në regjistrin e gjendjes civile për të vdekur, gjykata është njoftuar se “*pas kërkimin]t në Sullistemin e Gjendjes Civile dhe në Librat Themeltar të Lindjes, qytetari V.M. i regjistruar me numër perosnal ..., ka vdekte të regjistruar*”, njoftim ky i cili i është bashkangjitur shkresave të lëndës. Përveç kësaj, me kërkesën e gjykatës Agjencia e Regjistrimit Civil i ka ofruar gjykatës certifikatën e vdekjes me nr.ser. V 10672320 i datës për të pandehurin V.M., e cila certifikatë tani është pjesë e shkresave të lëndës.

Në dispozitën e nenit 158 par. 1 të KPP-së, është përcaktuar se “Kur gjatë rrjedhës së procedurës penale vërtetohet se i pandehuri ka vdekur, varësisht nga faza e procedurës penale, prokurori i shtetit apo gjykata merr aktvendim për pushimin e procedurës penale”. Si rrjedhojë e kësaj, gjykata duke pasur parasysh faktin se i pandehuri V.M. ka vdekur, në kuadër të këtij aktgjykimi, e ka refuzuar akuzën ndaj të pandehurit, më afër të pashkruar si në pikën II të këtij aktgjykimi.

Konform dispozitave ligjore të nenit 463 par.1 dhe 3 të KPP-së, të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest të rregullt juridiko-civil. Vendimin për shpenzimet e procedurës penale sa i përket hedhjes së aktakuzës, gjykata e mori konform nenit 453 par.1 të KPP-së.

Nga të dhënat e paraqitura më lartë gjykata konstaton se në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore që kundër të pandehurit V.M., të refuzohet akuza, kjo për faktin se ka rrethana të cilat e përjashtojnë ndjekjen penale, prandaj në pajtim me nenin 362 par. 1 pika 1.3 KPP-së, u vendos si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, e në bazë të neneve 242, 364 dhe 362 të KPP-së, u vendos si dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.3152/21 datë 18.06.2024

Praktikanti gjyqësor
Sulltan Qallapeku

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Bujar Ahmeti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej tridhjetë (30) ditëve prej ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.